

Zyra për Drejtat e Njeriut dhe Pakicave fton pjesëtarët e pakicës nacionale shqiptare, boshnjake dhe rome që të paraqiten në

„Programin për punë praktike për të rinjtë – pjesëtarë të pakicave në institucionet shtetërore në Serbi “

Qëllimi i këtij programi është që të i`u mundësohet pjesëtarëve të pakicave nacionale pjesëmarrje në jetën publike të Republikës së Serbisë. Të rinjëve nga nacionaliteti dhe nga dituritë e ndryshme akademike do të i`u mundësohet që për së afërmi të njoftohen me punën e institucioneve shtetërore për qëllim të rritjes së mundësisë për punësim në administratën shtetërore të Republikës së Serbisë për pjesëtarët e pakicave nacionale. Ky program parasheh përzgjedhjen e dhjetë (10) kandidatëve, të cilët do të kryejn praktikën për gjashtë muaj (6) në institucione shtetërore.

Kushtet:

Kandidatët duhet t`i plotësojnë kushtet në vijim:

- ✓ Të kenë të mbaruar arsimimin e lartë nga sfera e shkencës juridike ose nga sferat tjera shkencore rrespektivisht profesionale të shkallës së dytë (studimet akademike – master, studimet e specializimit, studimet e specializimit profesional), rrespektivisht të ndodhen në studimet themelore në periudhë më së paku 4 vjeçare ose të jenë student të vitit të fundit të studimeve të shkallës së dytë, rrespektivisht në vitin e 4 të studimeve në sferën e shkencave juridike ose në sferat tjera shkencore-profesionale në kuadër të sferës arsimoro-shkencore në fushën e shkencave shoqëro-ro-humaniste;
- ✓ Të kenë njohuri aktive të gjuhës serbe;
- ✓ Të jenë shtetas të Republikës së Serbisë;
- ✓ Të jenë shumë të motivuar, komunikativ, kreativ dhe profesional në raport me punën.

Paraqitja:

- Formularin aplikues – kandidatët e interesuar duhet t`a plotësojnë formularin aplikues të shpallur në ueb faqen e Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave www.ljudskaprava.gov.rs, si dhe të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë www.kt.gov.rs.

Formularit aplikues është e nevojshme t`ia bashkangjitni:

-letrën motivuese

- fotokopjen e vërtetuar të diplomës mbi arritjen e arsimimit të lartë nga sfera shkencore juridike ose nga sfera profesionale në kuadër të sferës arsimoro-shkencore në fushën e shkencave shoqëroro-humaniste të studimeve të shkallës së dytë (studimet akademike – master, studimet e specializimit, studimet e specializimit profesional), rrespektivisht të studimeve themelore në periudhë më së paku 4 vjeçare, ose origjinalin apo fotokopjen e vërtetuar të vërtetimit mbi arritjen e arsimit të lartë në studimet e shkallës së dytë, rrespektivisht në studimet themelore me kohëzgjatje më së paku 4 vjeçare nga sfera shkencore juridike ose nga sfera profesionale në kuadër të sferës arsimoro-shkencore në fushën e shkencave shoqëroro-humaniste (për kandidatët të cilët kanë diplomuar, rrespektivisht kanë përfunduar fakultetin)

- origjinalin ose fotokopjen e vërtetuar të vërtetimit mbi regjistrimin e vitit të fundit të studimeve të shkallës së dytë nga sfera shkencore juridike ose nga sfera profesionale në kuadër të sferës arsimoro-shkencore në fushën e shkencave shoqëroro-humaniste (studimet akademike – master, studimet e specializimit, studimet e specializimit profesional), rrespektivisht vërtetimin mbi regjistrimin e vitit të 4 të studimeve themelore nga sfera shkencore juridike ose nga sfera profesionale në kuadër të sferës arsimoro-shkencore në fushën e shkencave shoqëroro-humaniste (për kandidatët të cilët janë ende student).

- origjinalin ose fotokopjen e vërtetuar të shtetësisë së Republikës së Serbisë.

Dokumentacionin e lartëpërmendur duhet t`a dërgoni me post ose t`a dorëzoni në zyrat për pranim (çdo ditë pune nga 7.30 deri 15.30):

Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave

Bulevar Mihajlla Pupina nr. 2

11 070 Novi Beograd

me shënim – „Programi për punë praktike për të rinjët – pjesëtarë të pakicave nacionale në institucionet shtetërore në Serbi“, më së voni deri më **17 nëntor të vitit 2014.**

Aplikimet dhe dokumentacionet dërguara për paraqitje të cilat janë jo të plota, të papërshtatshme dhe të vonëshme nuk do të shqyrtohen. Zgjedhja e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet formale do të kryhet në bazë të aplikimeve të dorëzuara dhe bisedave me kandidatët. Koha dhe vendi i intervistës do t`i komunikohet vetëm për ata kandidatë të cilët hynë në përzgjedhje të ngushtë.

Kandidatët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë me Zyrën për Drejtat e Njeriut dhe Pakicave, në të cilën kontratë do të jenë të potencuara të drejtat dhe detyrimet e tyre. Të gjithë kandidatët e zgjedhur do të marrin pagë mujore për punën e tyre.

Ftohen kandidatet e gjinisë femrore të marrin pjesë në këtë konkurs..

Të gjitha informacionet shtesë në lidhje me programin mund të i merrni me thirrje në numrin e telefonit: 011/22-506-59, 011/22-506-74, 062/80-55-010 ose përmes postës elektronike: internship@ljudskaprava.gov.rs.